

Në përputhje me kërkesat e nenit 33 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, themeluesit, kanë rënë dakord të krijojnë ndërmarrjen **“TRINGA” Sh.p.k.** dhe do të regjistrohet në Agjenci për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, në Qershorë 08, 2010, miratoi Statutin e Shoqërisë, si vijon:

STATUT I SHOQËRISË

Neni 1 Dispozitat Hyrëse

Statuti i Shoqërisë do të përcaktojë si në vijim:

- Emrin e Shoqërisë
- Adresa e Shoqërisë
- Emri dhe adresa e Agjenti i Regjistruar i Shoqërisë
- Qëllimi i biznesit i Shoqërisë
- Themeluesit e Shoqërisë
- Kohëzgjatja e Shoqërisë
- Kapitali themeltar i Shoqërisë
- Pronarët e Shoqërisë dhe interesi i tyre pronësorë
- Drejtori Menaxhues i Shoqërisë
- Shpërbërja dhe mbaresa e Shoqërisë

Neni 2 Emri i Shoqërisë

Emri Zyrtarë i Shoqërisë në Kosovë është **TRINGA Sh.p.k.**, (këtu e tutje **“Shoqëria”**).

Neni 3 Lloji dhe statusi i Shoqërisë

9.1 Shoqëria është e regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me status të personit juridik dhe të veçantë dhe dallueshëm prej pronarit;

9.2 Pronari e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk do të jenë përgjegjës për çfarëdo borxhe ose detyrime të shoqërisë, vetëm për shkak se janë pronarë.

Neni 4 Adresa e Shoqërisë

9.1 Adresa kryesore (selia e zyrës) e Shoqërisë është në Agim Ramadani Nr, 124, 10020 Prishtine, Republika e Kosovë, Republika e Kosovës;

9.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose njësi tjera në territorin e Kosovës dhe jashtë saj.

Neni 5 Agjenti i Regjistruar i Shoqërisë

9.1 Agjenti i Regjistruar i Shoqërisë është Asdren Gashi, me numrin e letërnjoftimit 1002466623, me adresë Agim Ramadani Nr, 124, 10020 Prishtine, Republika e Kosovë;

9.2 Agjenti i regjistruar i Shoqërisë do të jetë agjent ligjor i Shoqërisë për pranimin e procedimeve, njoftimeve, ose kërkesave të dorëzuar tek Shoqëria nga autoritetet publike, një person ose organizata tjera;

9.3 Deklaratat e Agjentit i Regjistruar për shërbimin në këtë kapacitet në Shoqëri do të bashkëngjitet Statutit të Shoqërisë.

Neni 6 Qëllimi i Biznesit dhe Aktivitetet e Shoqërisë

9.1 Qëllimi i biznesit i Shoqërisë është të zhvilloj dhe të angazhojë çdo aktivitet të ligjshëm në Kosovë;

9.2 Aktivitetet kryesore të biznesit të Shoqërisë në Kosovë janë të identifikuar nën kategoritë të biznesit të zbatueshëm në Kosovë, si në vijim:

4521 Ndërtimi i lartë dhe ndërtimi i ulët

4523 Ndërtimi i autostradave, rrugëve, aeroporteve dhe objekteve sportive
4525 Punimet e tjera të specializuara të ndërtimit
4534 Punime të tjera të instalimeve
4545 Kompletimet tjera ndërtimore
6420 Telekomunikimet
7220 Këshillime dhe sigurimi i pajisjeve programore (softwear-it)
7230 Përpunimi i të dhënave
7250 Mirëmbajtja dhe riparimi i makinave të tjera të kontabilitetit dhe makinave llogaritëse
7260 Veprimtaritë tjera të lidhura me makinat llogaritëse (informatike)
9.3 Shoqëria mund të angazhohet në aktivitete tjera të biznesit së bashku me aktivitetet e përcaktuara në paragrafin më lartë.

Neni 7 Kohëzgjatja e Shoqërisë

Shoqëria është themeluar për një kohë të pacaktuar.

Neni 8 Themeluesi i Shoqërisë

Themeluesi i Shoqërisë është personi si në vijim:

- a) Artan Berisha, me numrin e personal 120015896 dhe me adresë banimi ne Rr. e UCK-s nr. 17, 10010 Prishtine.
- b) Labinot Krasniqi me numër pasaporte 1003248817, me adrese banimi “Agim Ramadani”, Nr 55, 10000 Prishtinë, Kosovë

Neni 9 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë

9.1 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë është Labinot Krasniqi me numër pasaporte 1003248817, me adrese banimi “Agim Ramadani”, Nr 55, 10000 Prishtinë, Kosovë

9.2 Drejtori Menaxhues do të ketë autorizimin për menaxhimin ditor të operacioneve të Shoqërisë, në suaza të kufizimeve të përcaktuara nga mbledhja e pronarëve, të veprojë për dhe në emër të Shoqërisë para çdo autoritet publik të Kosovë, si person i autorizuar i Shoqërisë, dhe të nënshkruaj të gjitha marrëveshjet/kontrata dhe çdo dokument tjetër për dhe në emër të Shoqërisë, me përjashtim të vendimeve të mbledhjes të Pronarëve;

9.3 Drejtori Menaxhues do të ketë autorizimin për të punësuar zyrtarë tjerë të Shoqërisë, në suaza të kufizimeve të përcaktuara nga mbledhja e pronarëve;

9.4 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë detyrohet nga obligimi i kujdesit dhe i vlerësimit të duhur afarist, detyrimi i besnikërisë ndaj Shoqërisë dhe detyrimi për të mos i bërë konkurrencë Shoqërisë.

Neni 10 Kapitali themeltar i Shoqërisë dhe aksionet e Shoqërisë

9.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1.000,00 Euro (Një mijë Euro), i kontribuar në formë monetare;

9.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është i ndarë në 1000 aksione aksione të rëndomta, me vlerë nominale prej 1 € (Një Euro) për aksion;

9.3 Pronari mund të bëjë kontribute shtesë në kapitalin themeltar të Shoqërisë në mënyrën e përcaktuar me Marrëveshje të Shoqërisë.

Neni 11 Pronari i Shoqërisë dhe interesat e tij pronësore

9.1 Pronar i Shoqërisë është:

- 1. Artan Berisha, me numrin e personal 120015896 dhe me adresë banimi ne Rr. e UCK-s nr. 17, 10010 Prishtine, me pjesëmarrje prej 500 € ne kapitalin themeltar te Shoqërisë dhe pronar i 50 % të interesit pronësorë në Shoqëri, gjegjësisht 500 aksioneve.
- 2. Labinot Krasniqi me numër pasaporte 1003248817, me adrese banimi “Agim Ramadani”, Nr 55, 10000

Prishtinë, Kosovë, me pjesëmarrje prej 500 € ne kapitalin themeltar te Shoqërisë dhe pronar i 50 % të interesit pronësorë në Shoqëri, gjegjësisht 500 aksioneve.

9.2 Me vendim te Pronarit, interesat pronësore ne Shoqëri mund te evidentohen me certifikate te aksioneve, lëshuar nga Shoqëria

Neni 12

Te drejtat dhe obligimet e Pronarit te Shoqërisë

9.1 Pronari i Shoqërisë do te ketë të drejtë ne shpërndarjet nga ana e Shoqërisë, te cilat bëhen në kohen dhe mënyrën e përcaktuar me Marrëveshje te Shoqërisë;

9.2 Pronari i Shoqërisë obligohet te paguajnë kapitalin themeltar te përcaktuar për pagese;

9.3 Të gjithë të drejtat, autorizimet dhe obligimet e Pronarit të Shoqërisë janë te specifikuara me Marrëveshje e Shoqërisë.

Neni 13

Shpërndarja dhe përfundimi i Shoqërisë

9.1 Shoqëria do te shpërndahet dhe biznesi i saj do te përmbyllet me paraqitjen e njërës prej rrethanave ne vijim:

a) vendimi i Pronarit

b) pranimi i njoftimit për çregjistrimin nga regjistri;

c) pranimi i urdhrit te Gjykatës me te cilin kërkohet qe Shoqëria te përfundoje apo shpërndahet sipas ligjit te aplikueshëm ne Kosove, përfshire dhe jo vetëm kufizuar ne Ligjin për falimentim;

d) ndonjë rrethanë tjetër e përcaktuar me ligjin e aplikueshëm ne Kosove.

9.2 Procedura për shpërbërje vullnetare do te realizohet ne përputhje me dispozitat e Marrëveshjes se Shoqërisë dhe ligjit te aplikueshme ne Kosove.

Neni 14

Dispozitat përfundimtare

9.1 Nëse dispozitat e përmbajtura ne Marrëveshjen e Shoqërisë janë ne mospërputhje me Statutin e Shoqërisë, Statuti i Shoqërisë do te mbizotëroje.

9.2 Ky statut mund të përmirësohet dhe të ndryshohet me të njëjtën procedure që është lëshuar. Pronari do të bëj përmirësimet dhe ndryshimet.

9.3 Statuti do të hyn në fuqi me datën e themelimit të Shoqërisë.

Nënshkruar ne Prishtinë, në Mars 08, 2010